

## Informationen für ausländische Hilfesuchende

### Informacion për të huajt që kërkojnë ndihmë

Ju keni ardhur në Gjermani nga një vend i huaj dhe prisni një fëmijë. Në mënyrë që njerëzit me pak ose aspak të ardhura të kenë mundësi të blejnë pajisjet fillestare për foshnjën e tyre, në Gjermani ekziston ndihma ligjore.

Nëse jeni **azilkërkues**, ju mund të merrni ndihmë për pajisjet fillesare të foshnjës në **Zyrën Sociale (Ausländerbehörde)**. Kjo ndihmë jepet në natyrë ose me para në dorë.

Nëse jeni **një refugjat i regjistruar**, ju mund të kërkonti ndihmë nga **Qendra e Punës** për pajisjet e foshnjës.

Nëse ju keni ardhur në Gjermani për të punuar **si qytetar i Bashkimit Europian** dhe keni të ardhura të ulëta, ju mund të aplikoni në **Qendrën e Punës** për ndihmë për pajisjet për fëmijë.

Vendimin juridik për ndihmën për pajisjet e foshnjës, ju duhet ta ruani me kujdes.

Nëse kjo ndihmë nuk është e mjaftueshme për foshnjën tuaj, ju mund të aplikoni për ndihmë shtesë te **Fondacioni "Dorëpërdore" i Turingenit (Thüringer Stiftung HandinHand)**. Aplikimi duhet të bëhet **përpara lindjes së foshnjës**, në një qendër këshillimi për shtatzëninë.

Për këtë qëllim janë të nevojshme dokumentet e mëposhtme:

- Statusi i lejeqëndrimit (për azilantët, azilkërkuesit)
- Çertifikata e regjistrimit të vendqëndrimit nga Zyra e Regjistrimit të Banorëve (për shtetasit e BE)
- Pasaporta e nënës (Mutterpass)
- Vërtetim nga zyra sociale ose qendra e punës për mbështetjen tuaj mujore financiare
- Vërtetim nga zyra sociale ose qendra e punës për ndihmën për pajisje fëmijësh

Nëse dokumentet janë të disponueshme në mënyrë të plotë në qendrën e këshillimit, atëherë aplikacioni juaj do t'i dërgohet Fondacionit në Erfurt. Aty do të vendoset individualisht sipas rastit. Ndihma nga fondacioni nuk është një e drejtë ligjore.

Nëse Fondacioni vendos t'ju mbështesë financiarisht, ju do të merrni një letër nga Fondacioni „Dorëpërdore“ i Turingenit (Thüringer Stiftung HandinHand). Letra thotë se çfarë sendesh mund të blini me këto para.

Paratë e miratuara do të transferohen në llogarinë tuaj ose në llogarinë e qendrës së

këshillimit. Sapo paratë të jenë në llogarinë e qendrës së këshillimit, ju do të informoheni për këtë.

Shuma e parave nga fondacioni mund të ndryshojë. Ato përcaktohen sipas gjendjes personale të personit që kërkon ndihmë.

Duhet marrë në konsideratë gjërat e mëposhtme:

- **Nëse ndryshoni vendbanimin tuaj, duhet të tregoni menjëherë në qendrën e këshillimit adresën tuaj të re.**
- Brenda **4 javëve pas lindjes**, ju duhet të sillni në qendrën e këshillimit **një kopje të certifikatës së lindjes / dëshmi të lindjes së foshnjës**
- **Blini** nga paratë e miratuara **vetëm gjërat që janë të shënuara në letrën e fondacionit**. Paratë e pashpenzuara duhet t'i kthehen Fondacionit.
- **Duhet të ruhen dokumentet e blerjes (faturat, faturat me kupon, etj.)** për artikujt e blerë.
- **Mobiljet dhe pajisjet duhet të blihen të reja** (në dyqan apo nëpërmjet Internet-it).

Ekipi i Këshillimit për Shtatzëninë është në dispozicion për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve tuaja rreth shtatzënisë, lindjes, mamive, përgatitjes së lindjes, kontracepsionit, etj.